



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 17 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1665/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI189/19

Parashtrues

Alban Miftaraj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ-
UZPV. nr. 85/2019] të 26 qershorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Alban Miftaraj, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ-UZPV. nr. 85/2019] të 26 qershorit 2019, të cilin e ka pranuar më 15 korrik 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar [ARJ-UZPV. nr. 85/2019] të Gjykatës Supreme, të 26 qershorit 2019, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 29 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 8 nëntor 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 26 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës në Gjykatë dorëzoi dokumente shtesë.
9. Më 7 tetor 2020, Kolegji shqyrtues propozoi që shqyrtimi i kërkesës të shtyhet për plotësime shtesë.
10. Më 10 nëntor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës është i punësuar në Departamentin special Anti-korrupsion, i cili vepron në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: PSRK), që nga 15 prilli 2011.
12. Më 6 janar 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës nxori Vendimin nr. 02/151. Pika nr.4 e këtij vendimit përcaktonte rritjen e pagës bazë për të gjithë shërbyesit civilë, në lartësinë prej 30% (tridhjetë përqind).

Procedura administrative

13. Më 8 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.02/151 të 6 janarit 2011, parashtron kërkesë në Këshillin Prokurorial të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), për rritje të pagës mujore, në lartësinë prej 30%.
14. Më 4 mars 2013, KPK, përmes Vendimit KPK nr. 55/2013, refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rritje të pagës mujore në lartësinë prej 30%, duke konstatuar se *"Ekspertët Anti-korrupsion kompensohen me paga që janë jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civilë (koeficient), prandaj, gjeti se bazuar në nenin 10, paragrafin 3 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2013 nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për rritje të pagave prej 30% sipas Vendimit të Qeverisë. Gjithashtu, Këshilli vërejtë se pika 1.1 dhe 1.2 e paragrafit 1 të Vendimi të Qeverisë, të datës 13 shkurt 2013, Nr.13/155, "për kompensimin e shtesave dhe stimulimit financiar për punonjësit e PSRK për Vitin 2013", përcakton numrin e zyrtarëve dhe personelit mbështetës të cilët kanë të drejtë për kompensim shtesë, ndërsa Ekspertët Anti-korrupsion dhe dy zyrtarët e Teknologjisë Informative nuk janë të përfshirë në atë numër. Prandaj, duke konsideruar rëndësinë e trajtimit të barabartë të të gjithë punonjësve në PSRK, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi".*
15. Më 22 mars 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHC), kundër Vendimit të KPK-së, të 4 marsit 2013, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të ligjit procedural dhe material.
16. Më 5 prill 2013, KPMSHC me Vendimin nr. 737-02/132/2013, refuzon ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se: *"Në Ligjin mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, neni 10, paragrafi 3, Limitet në zotime dhe shpenzime, thuhet se: "Punonjësit e Organizatave buxhetore të Institucioneve të Pavarura që kanë pagat e tyre jashtë sistemit të pagave të Shërbyesve Civilë nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën për shujtë, kompensime të tjera dhe rritjen prej tridhjetë përqind (30%) sipas vendimit të Qeverisë". Që do të thotë se paga e juaj prej 870 euro është pagë fikse dhe e një niveli mjaft të lartë në krahasim me nëpunësit e tjerë, paga e të cilëve nuk është fikse, prandaj edhe nuk mund të shfrytëzoni të drejtën për rritje të pagës prej 30%. Po ashtu (sipas shkresave të lëndës) ju si ekspert përveç; pagës fikse paguheni me 30.00 euro SHCK dhe 50.00 euro shtesë të kufizuar, që do të*

thotë se te ardhura tuaja totale për një muaj janë në shumë prej 950.00, euro që nga muaji Maj i vitit 2011. (...) Kolegji i Këshillit pas analizës dhe sistemimit të provave, duke u bazuar në aktet ligjore në fuqi, si rezultat i të gjykuarit të tërësishëm, konstatoi se ankesa nuk është e bazuar dhe vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi, me të cilin mbetet në fuqi vendimi i nxjerr nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, KPK. nr. 55/2013 prot. nr. 289, me dt. 05.03.2013, më të cilin është refuzuar kërkesa e ankuesit për rritjen e pagës prej 30% pasi që edhe nuk kanë koeficient të përcaktuar si shërbyesit e tjerë civilë”.

Padia e parë (konflikti administrativ), kundër KPMSHC-së

17. *Më 3 maj 2013, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, kundër Vendimit të KPMSHCK-së, të 23 korrikut 2014, me pretendimin se “Vendimi i paditur përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës administrative, është nxjerrë në gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar, ndërsa ligji është zbatuar në dëm të tani paditësit, si pasojë e shkeljeve ligjore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike”.*
18. *Më 13 qershor 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.613/2013, aprovon padinë e parashtruesit të kërkesës dhe e rikthen në rivendosje Vendimin e KPMSHC-së, nr. 737-02/132/2013, të 5 prillit 2013, për shkak të mangësive në vërtetimin e fakteve dhe të shkeljeve thelbësore të dispozitave të ligjit procedural.*
19. *Më 23 korrik 2014, KPMSHC, me Vendimin A/02/299/2014, e hedhë poshtë, si të palejuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës, të aktivizuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 13 qershorit 2014, me arsyetimin vijues: “Ankuesi është ankuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës kundër Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me nr. 289/2013 të datës 05.03.2013, duke mënjeluar pa asnjë arsye Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të institucionit përkatës, dhe si rrjedhojë e kësaj, ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, ku përcaktohet se “para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës të arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda 30 ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm”.*

Padia e dytë (konflikti administrativ), kundër KPMSHC-së

20. *Më 15 gusht 2014, parashtruesi sërish ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative, kundër Vendimit të KPMSHCK-së, A/02/299/2014, të 23 korrikut 2014, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative dhe aplikimit të gabuar të ligjit material. Parashtruesi i kërkesës e kishte plotësuar padinë e tij më 14 prill 2016.*

21. Më 19 korrik 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, me Aktgjykimin A. nr. 1518/2014, aprovon padinë e parashtruesit të kërkesës, duke e kthyer çështjen sërish në rivendosje në KPMSHC, nga shkak se: *“Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk i ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të cituara më lart, kur me aktvendimin kontestues të datës 22.07.2014, e ka hedhur ankesën e paditësit të datës 07.07.2014, për mosshterjen e mjeteve juridike brenda organit të punësimit. Gjykata si rregull, për konfliktin administrativ vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri. Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative”*.
22. Më 25 korrik 2016, KPMSHC ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.1518/2014] të 19 korrikut 2016, për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe juridike.
23. Më 12 janar 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA.nr.324/2016, refuzon, si të pabazuar, ankesën e ushtruar nga KPMSHC dhe vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [A.nr.1518/2014] të 19 korrikut 2016, duke arsyetuar se: *“...gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, me të cilin ka anuluar vendimin e të paditurit, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditurit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm”*.
24. Më 3 mars 2017, KPMSHC me Vendimin A/02/332/2016, hedhë poshtë, si të palejuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës, e cila ishte aktivizuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 19 korrikut 2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, të 12 janarit 2017 me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit.

Padia e tretë (konflikti administrativ), kundër KPMSHC-së

25. Më 3 prill 2017, parashtruesi i kërkesës paraqet sërish padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër Vendimit të KPMSHC-së, A/02/332/2016, të 3 marsit 2017, për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe procedural, duke kërkuar anulimin e Vendimit të KPMSHC-së për shkak të shkeljeve të dispozitave të ligjit procedural.
26. Më 17 korrik 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A. nr. 598/2017, refuzon kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e Vendimit [A/02/332/2016] të KPMSHC-së, të 3 marsit 2017, me arsyetimin se nuk janë shterur mjetet juridike, ashtu siç parashiheshin me nenin 130 të Ligjit nr. 02/L-28 për

Procedurën Administrative dhe nenin 12, paragrafi 3.1 të Ligjit nr. 03/L-192 për KPMSHC-në.

27. Më 13 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën e Apelit parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, A.nr.598/2017, të 17 korrikut 2017, duke pretenduar: 1) vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, 2) aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe 3) shkelje esenciale të dispozitave procedurale.
28. Më 28 shkurt 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA.nr.466/2018, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi si të drejtë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.1518/2014, të 17 korrikut 2018, duke arsyetuar: *“...gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, dhe gjykata e shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Sepse paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike”.*
29. Më 13 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA.nr.466/2018, të 28 shkurtit 2019, duke kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë së tij, që lënda të kthehet në rigjykim ose të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të instancës me të ulët.
30. Më 26 qershor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ-UZPV.nr. 85/2019, refuzon si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikim të jashtëzakonshëm të vendimeve gjyqësore, me arsyetimin se: *“...pretendimet në kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, për shkak se nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendje tjetër faktike nga ajo se çfarë vërtetoi gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit”.*

Dispozitat ligjore relevante

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 203

Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese, po që se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtare.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 395

Reformatio in Peius

Në qoftë se është paraqitur ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimi për sa i përket cilësimit juridik të veprës dhe sanksionit penal nuk mund të ndryshohet në dëm të tij.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e kontestuarra të gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së.

(i) Pretendimet në lidhje me shkeljet e nenit 31 të Kushtetues dhe nenit 6 të KEDNj-së.

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtën e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të: i. pjesëmarrjes së një gjyqtareje në dy instanca gjyqësore, gjegjësisht në shkallë të parë dhe shkallë të dytë, pretendim që ngrit shkeljen e parimit të gjykatës së themeluar me ligj, ii. shkeljes së parimit *reformatio in peius* dhe parimit të çështjes së gjykuar (*res judicata*).

a. pretendimi i parashtruesit për “paanshmëri”

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: “... në marrjen e aktgjykimit të atakuar të Gjykatës së Apelit AA.m.466/2018 të dt. 28.02.2019, ka marrë pjesë gjyqtarja D.H., e cila është dashur të përjashtohet pasi e njëjta në të njëjtën çështje ka marrë Vendimin A. nr. 1518/2014, si gjyqtare në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë. Kjo shkelje përbën shkelje të tillë për të cilën sipas nenit 182.2 pika c) vendimi duhet të priset gjithmonë pavarësisht nëse vendimi i tillë është i drejtë apo i padrejtë”.

b. shkelja e parimit “reformatio in piues”

34. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se “Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.m.466/2018 i dt. 28.02.2019 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative A.nr.598/2017 i datës 17.07.2018, janë përfshirë edhe me shkelje nga nenet 194 dhe 213 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, nga shkak se është shkelur parimi “reformatio in peius” si një prej parimeve themelore të LPK-së, sepse: “... sipas këtij parimi pala nuk mund të vihet në pozitë më të keqe juridike me vendimin pasues sipas procedurës së mëvonshme që zhvillohet sipas kërkesës apo ankesës së tij”.

c. shkelja e parimit të çështjes së gjykuar (*res judicata*)

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se: “...gjykata e shkallës së parë ka marrë qëndrim për këtë çështje dhe ka vlerësuar se: “organi i paditur, nuk i ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore ... kur me aktvendimin kontestues të dt. 22.07.2014, e ka hedhur ankesën e paditësit të dt. 07.07.2014, për mosshterjen e mjeteve juridike brenda organit të punësimit”. Ky Aktgjykim është vërtetuar

me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA.nr.324/2016 të datës 12.01.2017, andaj kjo çështje ka marrë epilog përfundimtar dhe nuk mund të trajtohet edhe njëherë as nga organi administrativ as nga gjykata pasi që kjo çështje përbën çështjet të gjykuar “res judicata”.

(ii) Pretendimet në lidhje me shkeljet e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

36. Parashtruesi i kërkesës shkeljen e të drejtave pronësore e ndërlidhë me të drejtën e tij për kompensimin e diferencës së pagës në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 02/151, duke pretenduar se ky kompensim, gjegjësisht kjo e drejtë i buron atij nga neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës. Parashtruesi i kërkesës tutje argumenton se në bazë të këtij vendimi ai ka krijuar “pritje legjitime” për pagesën e rritjes së pagave ndërsa kërkesa e tij konsiderohet kërkesë pasurore pasi përmbush konceptin e pasurisë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, duk u thirrur në rastet e *GJENDJ-së Pine Valley Developments Ltd* dhe të tjerët kundër Islandës dhe *Broniowski* kundër Polonisë. Për më tepër, në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës shton se:

“E drejta për ta gëzuar pagën, është një e drejtë e fituar që paraqet një doktrinë juridike sipas të cilës një e drejtë e fituar në bazë të normave ligjore të mëparshme nuk mund të kufizohet me ligje apo akte të nxjerra me vonë. Doktrina e së drejtës së fituar (acquired right) lidhet ngushtë me parimin e sigurisë juridike andaj bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, një e drejtë e cila është fituar në bazë të ligjeve të mëparshme nuk mund të ndryshohet me vendim të mëvonshëm të Organit Administrativ dhe mbi këtë bazë të drejtat e njohura me parë për individët (pritjet legjitime), duhet të respektohen”.

Në rastin Grudic kundër Serbisë, i cili në mënyrë analoge mund të aplikohet në rastin konkret, GJEDNJ kishte konsideruar të papranueshëm argumentin e Qeverisë së Serbisë se nuk janë shterë të gjitha mjetet juridike me arsyetim se asnjë mjet administrativ brenda kompetencave të Organeve Administrative nuk do të ishte efektiv për këtë çështje, andaj nuk mund të pritej nga kërkuarësit që të pretendonin zgjidhje të rastit në ndonjë forum tjetër.

Ndërkaq, për meritat e rastit, Gjykata filloi duke rikujtuar se neni 1 i këtij Protokollit nuk garanton të drejtën për të marrë pronë e as të drejtën në pension (në rastin konkret lexo pagë) të një shume të caktuar; por, megjithatë, kur një shtet ka në fuqi legjislacion që ofron pagesë si e drejtë për pension - ai legjislacion duhet të konsiderohet se gjeneron një interes pronësor, që bie brenda sferës së nenit 1 të Protokollit nr. 1. Prandaj, zvogëlimi ose mosvazhdimi i pensionit mund të përbëjë ndërhyrje në gëzimin paqësor të pasurisë. Kur Gjykata vlerësoi legjislacionin vendor mbi këto pensione, nuk vërejti se kishte ndonjë dispozitë e cila do të sqaronte pse janë ndërprerë pagesat e këtyre pensioneve.

(...)

Ndërsa nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 02/151 nuk ka asnjë dispozitë që kufizon apo përjashton paditësin nga gëzimi i kësaj të drejte, andaj rrjedhimisht paditësi ka fituar të drejtën në rritjen e pagesës sipas vendimit kontestues dhe kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet sepse e njëjta

përmban pasuri dhe është e drejtë e garantuar sipas KEDNj- neni 1 i Protokollit 1. Po ashtu, vet sekretari i MAP-it në emailin e dërguar përmes emailit zyrtar nuk e konteston në asnjë moment të drejtën për rritje të pagës prej 30% në bazë të Vendimit të Qeverisë nr. 02/151, por kërkon nga institucioni që të sigurohet që ka mjete (para) të mjaftueshme në mënyrë që të ekzekutohet pagesa prej 30%”.

37. Përveç kësaj parashtruesi i kërkesës pretendon dhe në shkelje të nenit 49 dhe 55 të Kushtetutës.
38. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon të:

“ANULOHET Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, me numër ARJ-UZPV.nr.85/2019 të dt. 26.06.2019 dhe aktgjykimet e gjykatave që janë nxjerrë para vendimit të Gjykatës Supreme, dhe çështja i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo që Gjykata Kushtetuese të vendosë vet në mënyrë meritore dhe të konstatojë shkeljet kushtetuese, me ç’rast iu është mohuar e drejta për rritje në pagë nga Këshillin Prokurorial të Kosovës/Prokuroria Speciale e Kosovës për realizimin e kompensimit të diferencës në të ardhura në shumën prej 30% në të ardhura bruto, duke filluar nga data 15.04.2011, e deri në pagesën definitive”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

41. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

42. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe e konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ-UZPV. nr. 85/2019] e Gjykatës Supreme të 26 qershorit 2019, pasi i ka shterur mjetet juridike në kuptimin formal. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
43. Megjithatë, përveç kësaj Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me paragrafët (1) (b) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

(1) “Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:

[...]

(b) janë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj kundër aktgjyimit ose aktvendimit të kontestuar;

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

44. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 49 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.
45. Në këtë kontekst dhe në vijim, Gjykata do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me (i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të

Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së; (ii) shkeljet e pretenduara të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe shkeljet e pretenduara të neneve 49 dhe 55 të Kushtetutës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

46. Në lidhje me shkeljen e të drejtës në “gjykim të drejtë dhe të paanshëm” Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ngritë tri pretendime, që kanë të bëjnë me: a) paanshmërinë në vendimmarrje; b) shkeljen e parimit *reformatio in peius*; dhe c) shkeljen e parimit të çështjes së gjykuar (*res judicata*).

a) Në lidhje me “paanshmërinë në vendimmarrje”

47. Gjykata fillimisht rikujton se çdo pretendim i ngritur në kërkesë nga parashtruesit e kërkesave në Gjykatë kërkon dhënien e një përgjigjeje konkrete nga ana e Gjykatës, me kushtin që parashtruesit e kërkesave i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
48. Njëri ndër këto kriteret është edhe ai i shterimit të mjeteve efektive juridike. Gjykata rikujton se kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur, janë mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin formal (shih, ndër të tjera, parimet e përgjithshme përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në rastet e Gjykatës KI108/18, me parashtrues *Blerta Morina*, paragrafët 152-163 dhe KI147/18, me parashtrues *Arbër Hadri*, paragrafët 39-50). Por, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ajo gjithashtu ka ndërtuar praktikën gjyqësore përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues *Basri Deva*, *Afërdita Deva* dhe *Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 gushtit 2019, paragrafët 90-96).
50. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton detyrimin e përdorimit të mjetit juridik kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut

të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës i kanë shfrytëzuar ato në të dy kuptimet, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI71/18, parashtrues *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafin 73; dhe rastin KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafin 94).

51. Aspekti substancial i shterimit të mjeteve juridike është i përcaktuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës dhe nënkupton që pretendimet për shkelje të KEDNJ-së dhe të Kushtetues, duhet të jenë ngritur “të paktën në substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që të njëjtave t’u jetë dhënë mundësia për të adresuar pretendimet për shkelje përkatëse (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI01/19, parashtrues: Fatos Rizvanolli, Aktvendimi për papranueshmëri, i 2 shtatorit 2020, paragrafët 96-100 dhe referencat e cituara në këtë rast).
52. Në këtë drejtim, GJEDNJ, gjithashtu përcakton që parashtruesit e kërkesave nuk mund të lirohen nga detyrimi i shterimit të mjeteve efektive juridike edhe nëse gjykatat e rregullta mund të kenë qenë të detyruara të shqyrtojnë vet (ex officio) pretendimet përkatëse (shih, për më tepër përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial, Udhëzuesin e GJEDNJ-së, Kriteret e pranueshmërisë, të 30 prillit 2019, Pjesa I. Bazat Procedurale të papranueshmërisë; A. Mosshterimi i mjeteve juridike; 2. Aplikimi i rregullit; d. Pretendimet e Ngritura në Substancë).
53. Për më tepër, GJEDNJ mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72).
54. Nga sa më sipër, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse përtej shterimit të mjeteve juridike në aspektin formal e që është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë shteruar mjetet juridike edhe në kuptim substancial, përkatësisht nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në substancë, janë ngritur edhe para gjykatave të rregullta.
55. Përkitazi me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se në Gjykatën e Apelit (AA.m.466/2018, 28 shkurt 2019), pjesë e vendimmarrjes ishte gjyqtarja D.H., e cila kishte marrë pjesë si gjyqtare në gjykatën e shkallës së parë në vendimin A. nr. 1518/2014, të 19 korrikut 2016, dhe ky fakt sipas tij përbën shkelje të nenit 182.2 pika c) të Ligjit të Procedurës

Kontestimore dhe rrjedhimisht shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së.

56. Në rastin konkret, Gjkata vëren se pas pranimi të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA. m. 466/2018, të 28 shkurtit 2019, parashtruesi i kërkesës, kundër të njëjtit, kishte ushtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme. Në këtë kuptim, Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës kishte dijeni për pjesëmarrjen e gjyqtarës D.H., në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, e cila kishte vendosur lidhur me ankesën e tij të 13 gushtit 2018, para se t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës Supreme. Megjithatë, nga shkresat e lëndës dhe nga përmbajtja e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, vërehet qartë se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur si pretendim në Gjykatën Supreme çështjen e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, në kontekst të “gjykimit të paanshëm”, para se të njëjtin ta ngrente drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese.
57. Në këtë këndvështrim, Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se i ka shterur të gjitha mjetet efektive juridike në kuptim substancial, që nënkupton se deklarimi i shkeljes së të drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, do të duhej ngritur si çështje në Gjykatën Supreme, në mënyrë që Gjykata Supreme të kishte mundësinë e korrigjimit të shkeljes së Kushtetutës. Respektimi i parimit të subsidiaritetit kërkon pikërisht lejimin e rrugës dhe hapësirës së nevojshme për gjykatat e rregullta ta kryejnë detyrën e tyre për zbatim të drejtpërdrejt të Kushtetutës dhe KEDNj-së.
58. Gjykata dëshiron të rikujtojë, gjithashtu se përjashtim nga detyrimi i shterimi të mjeteve juridike vjen në shprehje vetëm atëherë kur Gjykata bindet se shfrytëzimi i mjetit juridik përkatës mund të mos jetë efektiv në dhënien e një përgjigjeje të arsyetuar një pretendimi për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në rastin konkret mjeti juridik në Gjykatën Supreme është ushtruar nga vetë parashtruesi i kërkesës dhe pretendimi i tij ishte brenda fushëveprimit të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, i cili i obligon gjykatat e rregullta, sipas nenit 53 dhe 102 të Kushtetutës, ti japin përgjigje parashtruesve të kërkesës në të gjitha fazat e procedurës, deri në përfundimin e çështjes. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës e ka lëshuar një mundësi të tillë, duke mos e ngritur shkeljen e “paanshmërisë” në Gjykatën Supreme.
59. Andaj, duke i marrë parasysh rrethanat se ky pretendim specifik i parashtruesit të kërkesës është ngritur për herë të parë në Gjykatë, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës Supreme të adresojë këtë pretendim dhe me këtë rast, të parandalojë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; dhe rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74).

b) Në lidhje me shkeljen e parimit “reformatio in peius”

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës shkeljen e parimit *reformatio in peius* e ndërlidhë me faktin se: “... sipas këtij parimi pala nuk mund të vihet në pozitë më të keqe juridike me vendimin pasues sipas procedurës së mëvonshme që zhvillohet sipas kërkesës apo ankesës së tij”.
61. Në këtë kontest, Gjykata përsërit se parimi “*reformatio in peius*” gëzon mbrojtje nga neni 31 i Kushtetutës, kur ky nen interpretohet në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së, sepse ka të bëjë me të drejtën e individit për t’u ankuar (shih, Gjykata Kushtetuese, rasti KI70/18, parashtrues: *Alfred Zylfaj*, Aktvendimi i 6 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
62. Gjykata vë në pah se si parim “*reformatio in peius*” sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës zbatohet si rregull për çështjet civile, penale dhe administrative, kur kemi parasysh nenin 63 të Ligjit nr.03/L 202 për Konfliktet Administrative, i cili përcakton: “Nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore”. Megjithatë, në rrethanat e këtij rasti, Gjykata konsideron se ky parim është i paaplikueshëm sepse nuk kemi vendosje të meritave të çështjes ku me vendimet e mëparshme të gjykatave të rregullta, përkatësisht para 12 janarit 2017 është vendosur në dobi të parashtruesit të kërkesës dhe pas kësaj date është vendosur në dem të tij, sepse gjykatat e rregullta asnjëherë dhe përgjatë gjithë procedurës së zhvilluar administrative nuk kanë vendosur për meritat e çështjes.
63. Fakti që gjykatat e rregullta e kthyen disa herë çështjen e parashtruesit të kërkesës në rivendosje në KPMSHC, nuk nënkupton se vendimet e gjykatave të rregullta (para 12 janarit 2017) ishin në favor të tij, sepse çështja ishte kthyer në rivendosje për të pasqyruar drejtë faktet e rastit. Më pas, më 3 mars 2017, KPMSHC me Aktvendimin A/02/332/2016, bazuar në Ligjin për KPMSHC-në konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk mund të trajtohet në merita, sepse e njëjta nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike brenda organit të punësimit (punëdhënësit). Rrjedhimisht, gjykata e rregullta përfundimisht e pranuan si të drejtë konstatimin e KPMSHC-së, të dhënë në Aktvendimin A/02/332/2016, të 3 marsit 2017. (Shih, me sipër, Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr.598/2017, të 17 korrikut 2018, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA.m.466/2018 të 28 shkurtit 2019 dhe Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, ARJ-UZPV. nr. 85/2019, të 26 qershorit 2019).
64. Për më tepër, Gjykata shikuar procedurën në tërësi, vë në pah se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideroi relevante për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI118/17, parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16

shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GjEDNj, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

65. Tutje, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk është pajtuar me rezultatin e procedurës së zhvilluar në gjykatat e rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrenë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GjEDNj, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, rasti nr. KI56/17, parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
66. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se në rastin e tij është shkelur e drejta për gjykim të drejtë si rezultat i shkeljes së parimit *reformation in peius* në baza kushtetuese është qartazi i pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores se punës dhe rrjedhimisht e papranueshme.

c) Në lidhje me shkeljen e parimit të çështjes së gjykuar (*res judicata*)

67. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se çështja e tij ka marrë epilog përfundimtar me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA. nr. 324/2016, të 12 janarit 2017, andaj kjo çështje nuk mund të trajtohet edhe njëherë as nga organi administrativ as nga gjykata, pasi kjo çështje sipas tij përbën çështje të gjykuar/*res judicata*.

Parimet e përgjithshme

68. Gjykata, rikujton që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GjEDNj-së, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI122/17, parashtrues: *Ceska Exportni Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, dhe rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87, shih gjithashtu rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendimi i 13 majit 2020, paragrafi 42).
69. GjEDNj, në lidhje me rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike konstatoi se "*një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje*" (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI89/13, parashtruese: *Arbresha Januzi*, Aktgjykim i 12 marsit 2014, paragrafi 83, KI122/17, parashtrues: *Ceska Exportni Banka A. S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4

janarit 2017, paragrafi 87, dhe rastin KI94/13, parashtrues: *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014, shih gjithashtu rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendimi i 13 majit 2020, paragrafi 43).

70. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GjEDNJ-së e përmendur më sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite, theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së përfshin parimin e sigurisë juridike, i cili përfshin parimin që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave (shih rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendimi i 13 majit 2020, paragrafi 44).
71. Rrjedhimisht, në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GjEDNJ-së është theksuar se njëri nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon *respektimin e vendimeve të formës së prerë, res judicata* (shih rastin *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999, paragrafi 62). Sipas GjEDNJ-së “asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNJ-së *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, GjEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, par. 52, dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafi 72; shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, rastin nr. KI55/18, parashtrues *Fatmir Pirreci*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykimi i 16 korrikut 2012, par. 42 dhe rastin nr. KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014, shih po ashtu rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendimi i 13 majit 2020, paragrafi 45).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

72. Në këtë drejtim, në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se me asnjë vendim të autoriteteve publike nuk janë vendosur meritat e çështjes. Për të shqyrtuar meritat e një padie/ankese ligjet procedurale në fuqi kërkojnë përmbushjen e disa kriterëve procedurale të cilat janë parakusht i shqyrtimit të një çështjeje juridike në themel (substancë).
73. Gjykata rikujton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të parimit *res judicata* ndërlidhet me vendimet e KPMSHCK-së dhe të gjykatave të rregullta pas 12 janarit 2017, kur Gjykata e Apelit konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 19 korrikut 2016, me të cilin u vendos kthimi i çështjes në rigjykim në KPMSHCK, me arsyetimin: “... Gjykata si rregull, për konfliktin administrativ vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri. Në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative”.

74. Gjykata vë në pah se, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk kishte vendosur për themelin e padisë, por për rikthimin e çështjes në rigjykim në KPMSHCK, i cili më 3 mars 2017, përmes Vendimit A/02/332/2016, hedhë poshtë, si të palejuar, ankesën e parashtruesit të kërkesës, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike, brenda institucionit të punësimit. Ky konstatim i KPMSHCK-së u konfirmua nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin A. nr. 598/2017, të 17 korrikut 2018, me arsyetimin:

“Gjykata pasi që ka administruar provat si më lart ka konstatuar se nuk është kontestuese se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 02/151, të dt.06.01.2011, janë ngritur pagat për Shërbyesit Civilë, prej 30% mbi pagën bazë, duke përjashtuar shtesat. Por fakti që ankuesi paraprakisht nuk ka parashtruar ankesë te organi i punësimit si dhe pasi që paditësi kontratën e ka marrë me dt.15.04.2011, ndërsa akt emërimit e merr nga Zyra e Prokurorit me dt.26.02.2013 në pozitën Ekspert, shërbyes civil i karrierës me pagë fikse, pa ndonjë koeficient të përcaktuar. Në këtë gjendje të konstatuar nga shkresat e lëndës gjykata pasi i vlerësoi provat një nga një me kujdes ka ardhë në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se është i dëmtuar sa i përket zbatimit të vendimit të lartcekur të Qeverisë së Republikës së Kosovës (pasi që i njëjti është rekrutuar në ndihmë task forcës Anti-korrupsion, me pagë fikse e cila pagë është me e lartë se e shërbyesve civilë e ku nuk është i përcaktuar koeficienti dhe për këtë fakt këtu paditësi me rastin e themelimit të punës me dt.15.04.2011 ka qenë në dijeni prandaj mbi këtë arsye me gjykata ka vlerësuar dhe ka vendosur si dispozitiv të këtij aktgjykimi.”

75. Aktgjykimi i sipërcekur i Gjykatës Themelore u konfirmua më pas nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AA. nr. 466/2018 të 28 shkurtit 2018, e cila refuzimin si të pabazuar të ankesës së parashtruesit të kërkesës e arsyeton:

“Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së; dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, dhe se në të njëjtin vendim janë arsyetuar faktet noterë të cilat nuk janë paraqitur në ankesë, e as më herët në kërkesë, apo në çfarëdo shkrese tjetër që është objekt i kësaj padie. Këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, dhe gjykata e shkallës së parë, dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Sepse paditësi me asnjë provë nuk ka vërtetuar pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.”

76. Për më tepër, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, i 28 shkurtit 2018, u konfirmua nga Gjykata Supreme, me arsyetimin vijues:

“Duke marrë parasysh faktet e pamohueshme të lartcekura si dhe në bazë të dispozitave të lartpërmendura të nenit 130 të Ligjit nr. 02/L-28 (Për Procedurën Administrative), dhe nenin 12. nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kjo gjykatë ka konstatuar se paditësi ka parashtruar ankesë tek i padituri, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa iu drejtuar paraprakisht Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Prokurorial ose ndonjë organi tjetër të Këshillit Prokurorial. Nga sa u tha, kjo gjykatë ka konstatuar se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar drejtë kur kanë refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nr. 02/332/2016 të datës 01.03.2017. Sipas mendimit të kësaj gjykate, e paditura, në procedurë të paraparë ligjore, ka vepruar drejtë kur ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e paditësit Alban Miftaraj. Nga sa u tha me sipër, Gjykata Supreme gjeti se pretendimet në kërkesën e paditëses për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, për shkak se nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendje tjetër faktike nga ajo se çfarë vërtetoi gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjyqimit të kontestuar janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.”

77. Gjykata, bazuar në si më sipër, vëren se gjykatat e rregullta në të vërtetë nuk kanë vendosur përkitazi me themelin e padisë por për kriteret procedurale të lejueshmërisë së padisë, andaj në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me ndërhyrje në “çështjen e gjykuar” siç pretendon parashtruesi i kërkesës, sepse në asnjë procedurë nuk është vendosur për themelin e padisë së parashtruesit të kërkesës, nëse atij do t’i takonte ose jo rritja e pagës në lartësinë prej 30%, sipas Vendimit të Qeverisë nr. 02/151. Si të tillë, Gjykata në baza kushtetuese edhe këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës e konsideron qartazi të pabazuar.

(ii) Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

78. Gjykata vëren se pretendimin për shkelje të drejtave pronësore parashtruesi i kërkesës i ndërlidhë me të drejtat e “fituara” sipas Vendimit nr. të Qeverisë dhe “pritjet legjitime” nga ky vendim për rritje të pagës në lartësinë prej 30% (tridhjetë përqind), duke u thirrur në praktikën e GJEDNJ-së, përkatësisht në rastet *Pine Valley Developments Ltd* dhe të tjerët kundër *Islandës* dhe *Broniowski* kundër *Polonisë*, me pretendimin se të njëjtat janë të zbatueshme në rastin e tij.

79. Gjykata së pari rikujton përmbajtjen e nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, të cilat në lidhje me të drejtat pronësore përcaktojnë:

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.*
[...]

KEDNJ
Protokollit nr. 1 Neni 1 [Mbrojtja e Pronës]

1. *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Parimet e përgjithshme

80. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari thekson se paragrafi 1 i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe paragrafi 3 i nenit 46 të Kushtetutës garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të shpronësohet (shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës KI50/16, parashtrues i kërkesës Veli Berisha dhe të tjerët, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 marsit 2017, paragrafi 31).
81. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, Gjykata rithekson se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara; dhe, rregulli i tretë, ua njeh të drejtën shteteve që të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të nevojshme për arritjen e një qëllimi (shih *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së: *Sporrong dhe Lonngrot kundër Suedisë*, Aktgjykimi i 23 shtatorit 1982, ankesa nr. 7151/75; 7152/75, paragrafi 61; *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ankesat nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbajjan*, ankesa nr. 40167/06, 16 qershor

2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, ankesa nr. 53080/13, i 13 dhjetorit 2016).

82. Gjykata rikujton se të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenurit të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
83. Sa i përket rregullit të parë, GjEDNJ vazhdimisht ka konstatuar se koncepti i “pasurisë” i cili bën pjesë në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është një koncept autonom, që përfshin si “pasuritë ekzistuese” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri legjitime”. “Pasuritë” sipas këtij koncepti përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”, siç është pasuria e paluajtshme, e luajtshme dhe interesat e tjera pronësore.
84. Koncepti autonom i “pasurisë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i pavarur nga klasifikimi thjesht formal në ligjin vendor dhe nuk është i kufizuar në pronësinë e të mirave fizike: disa të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë “asete” mund të konsiderohen gjithashtu si “të drejta pronësore”, dhe kështu si “pasuri” për qëllimet e kësaj dispozite. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast veç e veç është nëse rrethanat e rastit, të marra si një tërësi, i janë dhënë parashtuesit të kërkesës si një e drejtë me interes thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së (shih, *Depalle kundër Francës* [GC], paragrafi 62; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [DHM], paragrafi 63; *Öneryıldız kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 124; *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], paragrafi 129; *Beyeler kundër Italisë* [DHM], paragrafi 100; *Iatridis kundër Greqisë* [DHM], paragrafi 54; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], paragrafi 171; *Fabris kundër Francës* [DHM], paragrafi 49 dhe 51; *Parrillo kundër Italisë* [DHM], paragrafi 211; *Béláné Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 76).

a) Pritshmëritë legjitime

85. Koncepti i “pasurisë” dhe i “pritjeve legjitime” kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me KEDNJ dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së. Nga ana tjetër, “pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës. Në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Béláné Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 73 dhe 75, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 34443/96 paragrafi 129). Në të kundërtën, asnjë “pritje legjitime” nuk mund të thuhet se lind, kur ka një mosmarrëveshje sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit vendor dhe kur kërkesat e parashtuesve më pas refuzohen nga gjykatat

kombëtare (shih GJEDNJ, rasti *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], paragrafi 65; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano v. Italy* [DHM], paragrafi 173; *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 75; *Karachalios kundër Greqisë* (vendim), paragrafi 46; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], paragrafi 149).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

86. Gjykata bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës në pronë dhe pasi analizoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me pretendimet për shkelje të së drejtës në pronë, vlerëson se rastet në të cilat është thirrur parashtruesi i kërkesës nuk janë të aplikueshme në rrethanat e këtij rasti konkret, sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore të fituar me një vendim gjyqësorë të formës së prerë dhe as me pritje legjitime nga shkaku se parashtruesi i kërkesës nuk ka një të drejtë të pohueshme se atij i takon rritja prej 30% e pagës bazë (shih, ngjashëm GJEDNJ rasti *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], parimin e paraqitur në paragrafin 52).
87. Gjykata si më sipër nënvizoi se neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës. Nuk është aspak kontestuese që paga si e mirë materiale në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së gjeneron një interes pronësor/pasuror. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës rritjen e pagës prej 30% e konsideron si të drejtë pronësore, bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 02/151, duke pretenduar se mospërfshirja e tij në listën e përfitimeve nga rritja e pagave prej 30% ka privuar atë nga e drejta e pronës. Megjithatë, Gjykata vlerëson se një pretendim i tillë do të ishte i bazuar po që se e drejta për përfitim nga rritja e pagave prej 30% do të konfirmohej në dobi të parashtruesit të kërkesës me një vendim përfundimtar nga ana e gjykatave të rregullta.
88. Në këtë vazhde, Gjykata serish përsërit se gjykatat e rregullta nuk kanë vendosur për substancën e padisë së parashtruesit të kërkesës, nëse atij do t'i takonte rritja e pagës prej 30 % ose jo, sepse për të arritur në një vlerësim të tillë sipas ligjeve në fuqi ligjvënësia ka paraparë përmbushjen e disa kriterëve procedurale, para se një kërkesë/ankesë të shqyrtohet në themelin e saj. Në rastin konkret, Gjykata vëren se me asnjë vendim administrativ a gjyqësor nuk është shqyrtuar në themel çështja e parashtruesit të kërkesës, nëse i takonte kjo rritje apo jo, për arsye se ai nuk i kishte shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, siç kërkonin dispozitat e ligjeve në fuqi.
89. Prandaj në rrethanat e këtij rasti nuk bëhet fjalë për një të drejtë pronësore të fituar ose të konfirmuar me vendim gjyqësor përfundimtar i cili nuk ka gjetur zbatim nga autoritetet publike, për çfarë mohimi i një të drejte të fituar, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së do të konsiderohej cenim i të drejtave pronësore.
90. Gjykata në këtë aspekt thekson se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, andaj pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë

(shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

91. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës në pronë është qartazi i pabazuar nga arsyet e lartcekura.

(iii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 49 dhe 54 të Kushtetutës

92. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar po ashtu shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 49 dhe 54 të Kushtetutës. Ne rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por as me një fjalë të vetme nuk arsyeton se si me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat kushtetuese nga nenet 32 dhe 54, si dhe nga neni 1 i Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendimi për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi* Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe së fundmi rastin KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63).
93. Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata në përputhje me praktikën e saj kërkesën e parashtruesit të kërkesës e deklaron qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përfundim

Si përmbledhje, sa i përket pretendimeve për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, nga ana e autoriteteve publike, Gjykata konstaton se kërkesa:

- i. në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, përkatësisht pretendimit për “paanshmëri në gjykim” duhet të shpallet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, për shkak të moshterimit të mjeteve juridike në kuptimin substancial;
- ii. në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit “*reformatio in peius*”, duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të këtij parimi;
- iii. në lidhje me pretendimin për shkelje të parimit të çështjes së gjykuar (*res judicata*), duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në pajtim me

rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, sepse nuk është konfirmuar se gjykatat kanë ndërhyrë dhe rihapur “çështjen e gjykuar”;

- iv. në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e Pronës] të KEDNj-së, duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës; dhe
- v. në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 49 dhe 54 të Kushtetutës, duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullave 39 (1) (b), 39 (2), si dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2020 njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi